



Nr. Prot.: 3498/23; Datë: 04.12.2023

Në bazë të vendimit nr. 3464/23, të datës 04.12.2023 të Këshillit Drejtues, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), me datën 04.12.2023 shpallë:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universtare për vitin akademik 2023/24

I

Kushtet e përgjithshme

1. Bursa universitare ndahet për studentët e nivelit të studimeve themelore (bachelor) dhe nivelit të studimeve master;
2. Të drejtë aplikimi për bursë kanë studentët e UShAF, të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - Të jenë studentë të rregullt të Fakulteteve të UShAF;
 - Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë (bachelor) dhe studentë të vitit të dytë të nivelit master;
 - Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
 - T'i kenë të dhëna të gjitha provimet e vitit paraprak të studimeve në afatin e shtatorit 2023;
 - Të kenë notë mesatare të studimeve 8.00 (tetë pikë zero) e më lartë.

II

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi, duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - Fletëparaqitjen (e cila merret përmes SMU-së);
 - Kopjen e letërnjoftimit;
 - Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare, e cila llogari duhet të jetë aktive. Llogaria bankare duhet të jetë e vet studentit që aplikon.
2. Dokumentet e kompletuara dorëzohen fizikisht në Zyrën e Shërbimit të Studentëve.
 - Administrata Qendrore është e obliguar që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë konkurs, t'i përgatit listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për përfitimin e bursës universitare;

- Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e sipërhënuara, Shërbimi i Studentëve nuk do t'ua pranojë fletëparaqitjen, e cila ua mundëson aplikimin për bursë.

III

1. Afati i aplikimit është prej datës **04.12.2023** deri më **11.12.2023** ora **15:00**.

IV

Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë të përfitimit të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankese tek Komisioni për Ankesa, në afat prej 48 orësh pas ditës së publikimit të listave.

Ankesat duhet të dërzohen në Zyrën e Shërbimit të Studentëve.